V E N D I M
Nr.566, datë 13.10.2001

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2001, MIRATUAR PËR GJYKATËN KUSHTETUESE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 dhe 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 7 të ligjit nr.8718, datë 19.12.2000 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2001", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1.Gjykatës Kushtetuese, në buxhetin e miratuar për vitin 2001, në zërin "Investime", t'i shtohet një fond prej 6 000 000 (gjashtë milionë) lekësh.

2.Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Gjykata Kushtetuese për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta